



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/69

Datë: 08.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 150,000.00 USD (njëqind e pesëdhjetëmijë dollarë Amerikan), për realizimin e pagesës fillestare për shpenzimet administrative, sipas kërkesës nga Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve Investive - ICSID (Arbitrazh) të datës 7 dhjetor 2015.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik që pagesën nga pika 1. e këtij Vendimi ta ekzekutoj deri më 11 janar 2016, në llogarinë bankare me të dhënat e paraqitura në kërkesën e Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve Investive - ICSID, të datës 7 dhjetor 2015.
3. Obligohet Ministria e Financave që mjetet nga pika 1. e këtij vendimi t'i ndanë nga rezerva e Qeverisë, nën programi, shpenzimet e paparashikuara, me kod 131 dhe t'i transferoj në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në kodin organizativ 213, nën-programi departamenti ligjor me kod 272, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/69

Datë: 08.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 8 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për angazhimin e kompanisë ligjore "Patton Boggs LLP" për ndërmarrjen e veprimeve procedurale/përgatitore me karakter urgjent, pranë Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve Investive ICSID (Arbitrazh) në çështjen e ngritur nga Kompania "ACT Axos Capital" GMBH për procesin e privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës Sh. A.
2. Për realizimin e këtij shërbimi ndahen mjete financiare në vlerë prej 17,600 USD (shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind dollarë Amerikan).
3. Obligohet Ministria e Financave që mjetet nga pika 2. e këtij vendimi t'i ndajë nga rezerva e Qeverisë, nën programi, shpenzimet e paparashikuara, me kod 131 dhe t'i transferoj në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik në kodin organizativ 213, nën-programi departamenti ligjor me kod 272, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, për realizimin e pagesës së shërbimit nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria Financave për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë